



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 12.

Prishtinë, më 27.07.2011 në ora 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Agim Kuleta, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik dhe Etem Arifi.

Munguan: Lirije Kajtazi, Petar Miletic dhe Rasim Demiri

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Lejla Selimi, përfaqësuesit nga KDI-Besnik Ramadani, përfaqësuesi i KKK-Veton Berisha, përfaqësuesi nga Presidenca-Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua vetëm një pikë e rendit të ditës:

- 1. Miratimi i raportit me rekomandime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës.

- 5. Miratimi i raportit me rekomandime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,**

Kryesuesi, tha se në mbledhje të ditës së kaluar, Komisioni shqyrtoi raportin me rekomandime të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, dhe se i njëjti nuk u miratua për arsye të vërejtjeve të shumta që kishte Komisioni rreth raportit të Komisionit për Integritet Evropian. Lidhur me këtë çështje hapi debat për gjetjen e një zgjidhje adekuate që Projektligj të procedohet në Kuvend.

Agim Kuleta – tha se i përmbahet diskutimeve të mëhershme se Projektligji është i parakohshëm dhe se nuk mund të hyjë në procedurë nëse nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Theksoi se në bazë të nenit 64, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku përmendet struktura e Kuvendit, në mënyrë implicite Kushtetuta parasheh se cilët përfaqësues të komuniteteve do të përfshihen si kategori kushtetuese në Kuvend. Propozoi që Projektligji të shtyhet deri sa të arrihen plotësim ndryshimet Kushtetuese.

Myzejene Selmani- në fjalën e saj tha se Kushtetuta e republikës së Kosovës është akti më i lartë juridik i shtetit. Mendon se çdo marrëveshje duhet të ratifikohet në bazë të Kushtes të Republikës së Kosovës dhe se asnjë marrëveshje politike nuk mundet të jetë mbi Kushtetutën.

Konstatoi se secili Ligj duhet të jetë i bazuar në Kushtetutë.

Ajo propozoi që Komisioni për ndryshime kushtetuese në nenin 64, pika 2, ku parashihet struktura e Kuvendit, me një nen të veçantë të definojë përfaqësimin e komuniteti malazez dhe atij kroat.

Rruga me e drejtë është që projektligji të mbetet në komision edhe për një periudhë kohore, pra deri në aprovimin e ndryshimeve Kushtetuese.

Albert Kinolli me theks të veçantë tha se Rekomandimin e dalur nga Komisioni për Integritet Evropian në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të legjislacionit të BE-së përkatësisht me kriterin e parimit të Kushtetutshmërisë.

Ai shtoi se BE-ja përmes Traktatit të Bashkimit Evropian – Traktatit të Mastrichit në Nenin 49, ku është përcaktuar që asnjë shtet nuk mund të aplikojë për anëtarësim në BE, nëse nuk i plotëson kushtet e parapara në nenin 6 të këtij Traktati i cili parasheh që Unioni është themeluar mbi parimin e sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Tradita e shteteve anëtare të BE-së përcakton se parimi i sundimit të ligjit është sigurimi i hierarkisë ligjore, që nënkupton përputhshmëria e ligjeve me aktin më të lartë juridik, Kushtetutën.

Lumnije Morina – theksoi se Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës është hartuar me qëllim të definimit të komunitetit malazez dhe atij kroat si komunitete të Republikës së Kosovës.

Në bazë se Projektligj nuk mundet të bie në ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës Duhet pasur parasysh faktin se kjo çështje nuk mund të realizohet pa ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 64 pika 2 (2), ku do të përfshiheshin edhe komuniteti malazez dhe ai kroat.

Ajo propozoi se në Nenin 3. të Projektligjit, duhet të shtohen edhe dy paragrafë të rri 12. 7 dhe 12. 8, ndërsa paragrafët tjerë t’iu ndërrohet radhitja numerike :

12.7 Këshilli Konsultativ për Komunitete do të përfaqësohet edhe nga komuniteti malazez dhe ai kroat, në momentin e ndryshimit të Nenit 64, paragrafi 2. (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

12.8 Për realizimin e këtij qëllimi, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që Komisionit për Ndryshime Kushtetuese t’ia jepet edhe kompetenca e ndryshimit të nenit 64, paragrafi 2. (2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ajo mendon se këto propozime duhet të inkorporohen në Raportin me amendamente të komisionit tan, si komision funksional.

Myfera Sinik- theksoi se miratimi i amendamentin 3, fjala ‘mund të jenë’ të zëvendësohet me fjalën ‘duhet të jenë’ është shumë i domosdoshëm për të gjitha komunitetet jo shumicë

Ajo dhe propozim konkret lidhur me nenin 3 paragrafi 12,6 të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me tekstin si në vijim;

Paragrafi 12,6, në rreshtin e nëntë të fshihet fjalia ‘malazez dhe atij korat’ ndërsa në fund të rreshtin njëzete e dy të shtohet fjalia ‘ Do të ketë edhe nga dy përfaqësues të komunitetit malazez dhe atij korat’, ndërsa teksti në vijim të mbetet si në projektligj.

Mzyejene Selamani nuk u pajtua me këtë propozim dhe shprehu mendimin e saj se Ligjet duhet të jenë të bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Përfaqësimi i komunitetit malazez dhe atij kroat nuk është i përfshirë në Kushtetutë. Me ndryshimin e Kushtetutës do të inkorporohen edhe komuniteti malazez dhe ai kroat si komunitete në Republikën e Kosovës.

Në bazë të diskutimeve të shumta, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim murr qëndrim që të kërkohet afat shtesë për paraqitjen e Raportit në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me tekstin si në vijim:

Në bazë të nenit 57.1,6 dhe 7 të Rregullores së punës së Kuvendit, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim është e obliguar si Komision funksional dhe raportues për shqyrtim dhe raportim në Kuvendin e Kosovës lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit br.03/l-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën Kosovës.

Lidhur me këtë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim kërkon nga Kuvendi i Kosovës që ta miraton kërkesën e komisionit për afat shtesë për paraqitjen e Raportit në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit br.03/l-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, në përputhje me procedurat e përcaktuara për finalizimin dhe procedimin e të njëjtit me qëllim të sigurimit të interesave vitale të komuniteteve të cilat janë të pranishme në Republikën e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic